

E DIELA II E KRESHMEVE

THIRRTORET

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe tri të Triodit në Tingëllin II:

PAS IKOS TU EFRATHA

Ç' këngë o Kryepriфт, ç' lëvdata të të qajmë? Ti je kollon' e Kishës, trumbeta e doktrinës, dhe tmerr' i heretikëve.

Ç' lule o Kryepriфт, ç' kurorë të të mpleksim? Je miku për shtërgatat, dhe mjeku për lëngatat, e trupeve dhe shpirtëve.

Ç' tingëll o Kryepriфт, ç' tropare të të psallim? Yll i Orthodoxisë, lëçitës i Trinisë, dhe drita e besnikëve.

LAVDI. Oshënar i trishlumur, Kryepriфт edhe Atë, bariu i mirë dhe dishepull i Kryebaruit Krisht, që vë shpirtin e vetë për dhëntë; ti dhe tani o Shën Grigor, kërko me nërmjetime, të na dhurohet përdëllim' i math.

Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.

LAVDI, T. T. IV. Gjuha jote e zgjuar për mësim, tingëllin në veshët e zëmrës, dhe i ngre shpirtet nga gjumi, dhe i shpie në qjell përpara Perëndisë; përandaj

o Shën Grigor, çudi e Thesalisë, nërmjeto pa reshtur pranë Krishtit, të ndriçohen ata që të nderojnë.

Përlëshorja e Tigëllit; pastaj:

PERLESHORJA E SHEN GRIGORIT, T. T. IV.
ORTHODHOKSIAS O FOSTIR

Yll i ndriçim Orthodox, themeli dhe mësonjës i Kishës së Zotit Krisht, o bukuri e murgëve, o përluftar i pamundur i theologëve, çudi po bën o Shën Grigor, me ty po mburret qyteti yt, hirin lëçit kudo, pra lut-u për ne gjithënjë, të shpëtohen shpirtet tona.

SHKURTORJA, T. T. IV.

PAS TI IPERMAKHO STRATIGO

Organ i shenjtë i Trinisë dhe i Zotit Krisht, ty o trumbetë theolloge oshëtitëse, të përhymnojm' o Shën Grigor Kryepriфт i lumur. Po si mëndje pranë Mëndjes rri tani në qjell, pra atje na shpjer tani At i shkëlqyer, se thërresim sot: Gëzohu Engjëll i Shpirtit Shenjt.

SHTEPIA

Një engjëll na u-çfaq përmi dhenë, që të na lajmëronjë misteret e fshehta të perëndishme, dhe na çuditi me zërin engjëllor, ndonëse kishte fytyrë njerëzore. Pra i thërresim sot: Gëzohu Engjëll i Shpirtit Shenjt.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Dytë të Kreshmëve, kujtojmë Shën Grigorin Pallamanë, Atin tonë dhe Kryepeshkopin e Selenikut.

Me nërmjetimet e tij, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

*Pastaj Zbritësoret: "Ja gojën e çel tani." Pas Dërgimësore
Ngjallësore, këndohen:*

DERGIMESORET, T. II

PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Gëzohu mburrj' e Atërve, gojë prej theollogu, o qetësi e murgëve, dhe shtëpi urtësie, o lartësi e mësimit, deti i diturisë; gëzohu vegl' e veprave, kulmi i theorisë dhe mjek me nam, për sëmudjet tona dhe për lëngatat, gëzohu Kish' e Shpirtit Shenjt, At' i gjallë pas vdekjes.

O Krijetar i botëve. . . (*Shiko të Dielën e Orthodoxisë*)

LAVDERIMET

Këndohen tetë, domethënë pesë të Tingëllit edhe tri të Triodit:

PAS TON URANION TAGMATON, T. I

Në botë shkove një jetë të lumur Engjëlli, tani pra me Shenjtorët, lart në qjell po gëzohesh, mi dhenë me të butët butë banon, Shën Grigor Kryeprift me nam, dhe ke dhuratë çudirash nga Zot' i Math, q' ua fal mëkatarëve.

Doktrina Orthodoxie mbolle kudo mi dhe, dhe gjëmbat e Skëterrës, pa mëshirë i preve, dhe besën e vërtet' e rrite me zell, me vaditjen e fjalëve, dhe një qint herë kallinj si një bujk besnik, Perëndis' i shpure lart në qjell.

Për jetën tënde të lumur Engjëjt' e qiellit, dhe njerëzit e dheut, u-çuditnë pa masë, se trupin e mundove rreptë si murk, dhe shkëlqeve si ashkëti, si meshëtar i dëgjuar dhe kryeprift, shërbëtor besnik i Zotit Krisht.

LAVDI, T. T. I. Për ata që baresin në errësirën e mëkatit, linde si dritë o Zoti Krisht, në kohën e përkorës. Pra edhe ditën e shënuar të Pësimit tënt, na e trego që të të thërresim. Ngjallu o Perëndi, dhe mëshirona.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlindëse Virgjreshë . .

*Doksollogjia e Madhe. Në Hyrjen Përlëshorja e Tingëllit,
e Shën Grigorit, dhe Shkurtorja "Përlufteshës Gjenerale."*

APOSTULLI

Ti, o Zot, ruajna dhe përkrahna.
Shpëto-më, o Zot, se humbi oshënari.
Këndimi prej Letrës së Palit për Efesianët.

Në krye ti, o Zot, e ke themeluar dhenë, dhe qjelli është vepër e duarve të tua. Ato do të humbasin, po ti do të mbetesh; edhe të gjitha do të vjetërohen si roba; edhe do t'i pështjellësh posi një veshje, dhe do të ndrohen; po ti je gjithay, edhe vjetet e tua nukë do të mbarohen kurrë. Edhe cilit prej Engjëjve i ka thënë nonjë herë: "Rri më të djathtën time gjer sa të t'i shtronj armiqtë nënë këmbët?" Vallë nukë janë që të gjithë shpirte meshëtare, që dërgohen për shërbimin e atyre, që kanë për të trashëguar shpëtimin? Përandaj duhet t'i vëmë re më tepër ato, që kemi dëgjuar, që të mos biem jashtë. Se nëqoftëse fjala e folur prej Engjëjve është e shigurtë, edhe çdo çbaritje dhe çdëgjim merr një çpërblim të drejtë, ahëre qysh do të shkapojmë ne, që

plogëruam një shpëtim aqë të math, i cili u-fol në krye prej Zotit, edhe na u-vërtetua prej atyre, që e kanë dëgjuar.

UNGJILLI PAS MARKUT

Më atë kohë, Jesuj hyri në Kapernaum, edhe dolli fjala që ishte në një shtëpi. Edhe menjëherë u-mblohnë aqë shumë njerës sa nukë kishte vënt më as afër derës; dhe ua predikonte fjalën. Dhe i vijnë, dhe i sjellin një ulok, të cilin e ngrenin katër veta, dhe meqënëqë nukë muntnin t'i afrohëshin nga turma, e zbuluan tavanin e shtëpisë, ku ishte; dhe passi e hapnë, e zbritnë shtratin, mi të cilin dergjej uloku. Dhe Jesuj, kur pa besën e tyre, i thotë ulokut: “Bir, të qofshin falur mëkatat.” Edhe disa prej Shkronjësve, që rrinin atje, mejtohëshin më vetë: “Ç’ janë këto blasfemira, që po flet ky njeri? Cili, përveç Perëndisë, munt të falë mëkata?” Dhe Jesuj e mori vesh menjëherë që po mejtohëshin kështu më vete, dhe u tha: “Përse mejtoheni kështu më vete? Ç’ është më lehtë t’i them ulokut, ‘Të qofshin falur mëkatat,’ apo t’i them. ‘Ngrehu, merr-e shtratin edhe barit.’ Po që ta dini se i Biri i njeriut ka fuqi të falë mëkata mi dhenë, (i thotë ulokut): “Ty të them, ngrehu, merr-e shtratin, dhe shko në shtëpi.” Edhe menjëherë u-ngrit, e mori shtratin, dhe dolli jashtë përpara të gjithëve, aqë sa që të gjithë çuditëshin, dhe lavdëronin Perëndinë, dyke thënë se “Kurrë nukë kemi parë kështu.”

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Basilit.